



***RAPORT PARAPRAK I VLERËSIMIT TE NDIKIMIT  
NË MJEDIS***



**“ IMPIANT PER PRODHIMIN E BETONIT DHE ASFALTO-BETONIT ”**

**ME VENDNDODHJE: FSHATI MAJKOSH, TEPELENE**

**SUBJEKTI: COBIAL SHA**

**Pergati : Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Denisa Kola'.

**TETOR 2015**



## ***Raporti i Vleresimit paraprak te Ndikimit në Mjedis***

“Impiant per prodhimin e betonit dhe asfalto-betonit”

**Kapaciteti: - i përpunimit të betonit do të 50m<sup>3</sup>/ore  
-i asfalto-betonit 100 ton/ore**

**Sipërfaqja territorit S= 4000 m<sup>2</sup>**

Siperfaqe oficine S = 200.50 m<sup>2</sup>  
Oficina + Zyra 1K S = 41 m<sup>2</sup>  
Zyra administrates 2K S = 27 m<sup>2</sup>  
Garazh S= 25 m<sup>2</sup>  
Magazine ekzistuese S = 64 m<sup>2</sup>

*Vendndodhje në fshatin Majkosh, Tepelene*

*E = 41°61'60.42”*

*N = 44°63'33.08”*

- *Shtojca II pika 5. Industria minerale. b) Instalime per prodhimin e cimentos*

**Hartoi Raportin: Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA**  
**Rishikoi Raportin: Ekspert Mjedisi Elgerti BIXHA**

GEC Studio  
 Rruga Vaso Pasha, Pall. 1, shk. 1,  
 ap.5, perball Magic 4, ish blloku,  
 Tirane, Albania

**PERMBAJTJA**

**KREU I.....5**

**HYRJE.....5**

1.1 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi.....6

1.2 Metodika e pergatitjes se studimit te VNM.....6

1.3 Infomacion mbi shoqerine.....8

**KREU II.....8**

**PERSHKRIMI I PROJEKTIT.....8**

2.1 Qellimi i zhvillimit te projektit.....8

2.2 Alternativa e analizuar.....8

2.3 Vendodhja e projektit.....9

2.4 Objektivat e projektit te propozuar.....11

**KREU III.....16**

**PERSHKRIMI I VENDIT DHE MJEDISIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI.....16**

3.1 Pershkrimi gjeologo-morfologjik i zones.....16

3.2 Regjimi Klimaterik.....16

3.3 Regjimi i Reshjeve.....16

3.4 Regjimi i Temperatures.....17

3.5 Regjimi Atmosferik.....17

3.6 Regjimi i Ererave.....17

3.7 Habitatet dhe Biodiversiteti.....17

3.8 Flora.....18

3.9 Fauna.....18

3.10 Sizmiciteti.....18

3.11 Hidrogeologjia.....18

3.12 Trashegimia arkitektonike, arkeologjike dhe historike.....19

**KREU IV.....20**

**PERSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT.....20**

4.1 Lenda djegese.....22

4.2 Programi i punes.....23

4.3 Plani i instalimit te linjes dhe afatet e zbatimit te tij.....23

4.4 Furnizimi me uje.....24

4.5 Rjeti i kanalizimeve te ujerave te zeza.....24

4.6 Furnizimi me energji elektrike.....24

4.7 Faza e funksionimit.....24

4.8 Mbetjet dhe emetimet ne mjedis.....25

**KREU V.....25**

**VLERESIMI I NDIKIMEVE.....25**

5.1 Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve.....	26
5.2 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave.....	27
5.3 Ndikimet ne rruge lokale dhe transport.....	27
5.4 Ndikimet ne flore dhe faune.....	27
5.5 Ndikimet ne toke.....	28
5.6 Ndikimet ne uje.....	28
5.7 Ndikimet ne ajer.....	28
5.8 Ndikimet ne klime.....	29
5.9 Ndikimet ne ekonomi.....	29
5.10 Ndikimet mbi trashegimine kulturore.....	29
5.11 Ndikimet me natyre nderkufitare.....	29
<b>KREU VI.....</b>	<b>29</b>
<b>MASAT PER ELEMENIMIN/ ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE.....</b>	<b>29</b>
6.1 Masat ndaj erozionit.....	29
6.2 Masat per emetimet ne ajer.....	30
6.3 Masat per uljen ne minimum te zhurmave.....	30
6.4 Masat per Shkarkimet ne uje.....	31
6.5 Masat per Depozitimet ne toke.....	31
6.6 Masat estetike dhe ekologjike.....	31
6.7 Masat rehabilituese, në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit.....	31
6.8 Masat ndaj zjarrit.....	33
<b>KREU VII.....</b>	<b>33</b>
<b>PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE.....</b>	<b>33</b>
<b>PLANI IMENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT .....</b>	<b>34</b>
7.1 Plani i menaxhimit .....	35
7.2 Plani i monitorimit te mjedisit .....	72
7.3 Auditimi mjedisor .....	37
<b>KREU VIII.....</b>	<b>38</b>
<b>KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>38</b>
8.1 Konkluzione .....	38
8.2 Rekomandime.....	39

## KAPITULLI I

### HYRJJE

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Sebashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme. Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne. Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithe. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta ( te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore. Vitet e fundit industria e ndertimit ne vendin tone ka patur nje zhvillim te madh. Kompanite e ndertimit ne vendin tone jane nder subjektet e biznesit me me teper fitim dhe qe zhvillojne nje aktivitet te madh ekonomik. Vet sektori i ndertimit ne vendin tone eshte nje nga shtyllat e ekonomise shqiptare dhe numeron nje numer te konsiderueshm te punesuarish, ne nje kohe qe kompanite e ndertimit sot jane nder taksa-paguesit me te medhenj te arkes se shtetit. Aktiviteti te cilin ne do te trajtojme eshte "Impiant prodhimi betony dhe asfalto-betoni" i cili i vjen ne ndihme industrise se ndertimit.

#### **Pasqyra e te dhënave kryesore**

**Projekti:** Impiant prodhimi betoni dhe asfalto-betoni

**Me vendndodhje:** Ne majkosh tepelene

**Kompania zhvilluese:** "COBIAL" sha

**Pergatiti raportin e VNM-se:** "GEC" Studio sh.p.k

Impianti ka nje siperfaqe rreth **4000 m<sup>2</sup>**

Kapaciteti maksimal: i betonit **50 m<sup>3</sup>/ore**

i asfalto-betonit **100 ton/ore**

## 1.1 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi

Ne Shqiperi fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen ne vitin 1993 , vit ne te cilin u hartua plani i pare i veprimit ne fushen mjedisore, qe perben dokumentin e pare zyrtar shqiptar mbi politikat mjedisore ne vend. Ky plan veprimi kombetar parashikonte se qeveria duhet te krijojte kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional per zgjidhjen e ceshtjeve mjedisore. Periudhen nga ky vit deri ne miratimin e Kushtetutes ne vitin 1998 mund ta konsiderojme si etapen e pare te zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit. Mbas vitit 1998 e ne vijim eshte periudha e dyte e zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e perafimit me legjislacionin e Bashkimit European per mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar eshte ne persosje dhe pasurim te vazhdueshem dhe zhvillimi i tij nuk i eshte len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislacionin europian te mjedisit.

- Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
- Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”
- Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
- Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’
- Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtingun e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.

## 1.2 Metodika e Studimit te VNM-se

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces qe siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

*Ndikimi* – efekti i zhvillimit te aktivitetit ne mjedis

*Vleresimi* – analiza qe i behet aktivitetit per evidentimin e ndikimeve negative dhe pozitive

*Mjedisi* – elementet abiotike ( kushtet fiziko- kimike te mjedisit) te kombinuara me elementet biotike ( qeniet e gjalle te mjedisit).

**Mjedisi fizik perbehet nga :**

- qeniet e gjalla ( flora , fauna)
- pjesa jo e gjalle ( toke, ajer, uje )
- peizazhe ( ndikimi vizuale)
- pasurit materiale
- pasuri kulturore ( interes historik, turizem )

**Mjedisi shoqeror ndahet ne :**

- personal
- nderpersonal
- institucional ( shendet, ekonomi, etj)

Per te ber nje vleresim sa me te sakte te ndikimeve ne mjedis nga zhvillimi i aktivitetit Studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua nga rendesia dhe madhesia e projektit, vendi ku ai ndodhet, pasurite natyrore dhe humane te zones si dhe vlerat e veçanta te tyre ne indentifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutese per eleminimin, zvogelimin e ndikimeve duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit.

**Studimi strukturohet ne kater faza kryesore :**

- 1.Ngritja e objektivave orientuese te V.N.M.
- 2.Shqyrtimi i materialeve teknike.
- 3.Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te mundshme biofizike dhe humane.
- 4.Hartimi i raportit te vleresimit te ndikimet ne mjedis sipas legjislacionit mjedisor.

Ky studim ka per qellim te jap konsideratat mjedisore te projektit te propozuar ne menyre qe te orientoje institucionet dhe organet vendim marrese ne dhenien e miratimin e lejes se kryerjes te aktivitetit.

**Per te arritur nje vleresim sa me real te territorit duhet te analizojme situaten duke evidentuar pikat kyce si:**

- Legjislacioni mjedisor
- Madhesia e projektit
- Pozicioni gjeografik ku do te zhvillohet
- Ndikimet e mundshme ne mjedis si pasoje e zhvillimit te aktivitetit
- Te dhenat gjeologjike te zones

- Te dhenat mbi floren dhe faunen e zones
- Historia arkeologjike dhe monumentet e kultures
- Popullsia , gjendja ekzistuese dhe e ndryshimeve

### 1.3 Informacion mbi shoqerine

Subjekti i cili do te zhvilloj aktivitetin ” **Impiant prodhimi betoni dhe asfalto-betoni**” eshte **COBIAL sha** i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 03-04-2000 dhe themeluar me date 28-09-1995 me numer NIPTI **K02715414M** , forma ligjore **Shoqeri Aksionere**. Subjekti zhvillon aktivitetin e prodhimit, tregimit dhe shperndarjes se betonit dhe asfalto-betonit. Duke qen keto produkte mjaft te perdorura ne industrine e ndertimit edhe kerkesat per prodhimin ,shtimin e kapacitetit dhe permiresimin e cilesise se markave kane ardhur duke u rritur. Shoqeria eshte e kontraktuar nga disa shoqeri ndertimi per furnizimin e tyre me beton dhe asfalto-beton te gatshem.

Kjo shoqeri ushtron aktivitetin ” **Impiant prodhimi betoni dhe asfalto-betoni**” me vendodhje ne Majkosh Tepelene.

## KAPITULLI II

### PERSHKRIMI I PROJEKTIT DHE VEPRIMTARISE

#### 2.1 Qellimi i zhvillimit te projektit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte prodhimi i betonit dhe asfalto-betonit te markave te ndryshme per industrine e ndertimit e cila vitet e fundit ka patur nje zhvillim te madh. Per te realizuar kete aktivitet shoqeria do te ndertoj nje linje me teknologji bashkekohore prodhimi. Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne prodhimin e produktit perfundimtar qe eshte betoni dhe asfaltobetoni do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij. .

Kjo zone eshte e preferuar per zhvillimin e aktivitetit sepse ndodhet anes Lumit Vjose, ne fshatin Majkosh Tepelene, rruga nacionale Tepelene-Fier, nuk eshte zone e mbrojtur, park kombetar, nuk ka monomente kulture, arkeologjike, vepra te ndertuara nga njeriu, zogj te eger dhe drure te rralle qe mbrohen me ligj. Kantieri i prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit ze nje siperfaqe 4000 m<sup>2</sup>. Pra me kete vleresim mjedisor japim informacion per projektin qe do te realizohet, vleresimin e ndikimeve negative dhe pozitive ne mjedis, si dhe masat qe do te merren nga investitori per zbatimin e kriterëve per mbrojtjen e menaxhimin e qendrueshem te mjedisit.

#### 2.2 Alternativa e analizuar

Perzgjedhja e kesaj zone ka ardhur si rrjedhoje e pronesise se tokes ne emer te kompanise, dhe certificates se pronesise qe ajo zoteron. Nuk eshte perzgjedhur alternative tjeter per realizimin e ketij projekti Zonimi funksional percakton qarte sistemin rrugor qe lidh zonen



me rruget ekzistuese. Trualli ne fjale eshte ne pronesi te kompanise e cila do bej investimet e nevojshme per ta plotesuar ate me te gjitha ndertimet e nevojshme per nje objekt konform kushteve teknike ku nuk do te mungojne parkimi, rruge te brendshme si dhe ndarja nga rruga kryesore me breza te gjelberuar.

### 2.3 Vendodhja e projektit

Aktiviteti do te zhvillohet ne fshatin Majkosh Tepelene.

Zona Kadastrale Nr. 2582, numer pasurie 183/13, ne pronesi te kompanise COBIAL sh.a

#### **Karakteristikat kryesore**

##### **Procesi i prodhimit te betonit**

- Te dhena teknike te impiantit te prodhimit te betonit

Marka: Euro mix

Viti i prodhimit: 2008

Vendi i origjines: Greqi

Kapaciteti: 50 m<sup>3</sup>/ore

- Te dhenat e procesit te prodhimit te betonit

#### **-Materialet qe perdoren**

1. Zhavorr lumi i franksionuar dhe i lare i dimensioneve 0÷4 mm, 4÷14 mm dhe 14÷24 mm.
2. Cimento e cila depozitohet ne sillose te mbyllura.
3. Uje

#### **-Procesi teknologjik**

Inertet e pregatitura dhe te lare hidhen te ndare sipas fraksioneve ne dozatore te vecante, te cilet kryejne procesin e dozimit dhe nepermjet nje transportieri dergohen ne perzjeres pasi jane peshuar me pare sipas fraksioneve perkatese. Me pas ne perzjeres shtohet cimento nepermjet nje sistemi te mbyllur dhe me ane te nje pompe cohet uji ne perzjeres.

##### **Procesi i Prodhimit te Asfaltobetonit**

- Te dhena Teknike te impiantit te prodhimit te asfaltobetonit.

Marka: WIBAU

Viti i Prodhimit : 2005

Vendi i origjines: Gjermani

Kapaciteti: 100 ton/ore

- Te dhenat e procesit te prodhimit te asfaltobetonit

#### **-Materialet qe perdoren:**

1. Zhavorr lumi i franksionuar dhe i lare i dimensioneve 0÷4 mm, 4÷14 mm dhe 14÷24 mm
2. Bitum i markes 50÷70 i prodhuar ne rafinerine e naftes Fier. Bitumi depozitohet ne cistern te mbyllura te pajisura me system ngrohje me gaz.

#### **-Procesi teknologjik**

Inertet e pregatitura dhe te lare hidhen ten dare sipas fraksioneve ne 5 dozatore te cilet kryejne dozimin paraprak dhe nepermjet nje transportieri dergohen ne baraban per tut hare. Barabani eshte i pajisur me nje llampe me gaz per te kryer procesin e tharjes dhe ngrohjes se inerteve. Pas perfundimit te procesit te tharjes, inertet me ane ten je elevator dergohen ne nje system sitash vibruese per tu ndare sipas fraksioneve perkatese. Pas ndarjes inertet kalojne ne sistemin e peshoreve, ku peshohen sipas fraksioneve dhe me pas me renie te lire dergohen ne mikser. Me ane ten je pompe, bitumi dergohet ne nje peshore te vecante dhe me pas procesit te peshimit ne perzjeres, ku kryhet procesi i perzierjes me inerte per 20 sek. Pas perfundimit te perzierjes asfaltobetonit i perftuar dergohet ne nje depozite me ane te nje elevator dhe me pas ngarkohet ne mjet per tu derguar ne objekt. Inpanti eshte i pajisur me nje aspirator te fuqishem per thithjen e pluhurave, ku nepermjet filtrave behet pastrami i tij. Materiali i mbledhur nga filtri riciklohet ne procesin e prodhimit te asfaltobetonit si nje komponent shume i rendesishem i tij. Ajri i emetuar ne atmosfer eshte gjithmon Brenda parametrave te kerkuara.

**Harta, planvendosjes se linjes se prodhimit betonit dhe asfalto-betonit, pozicioni topografik shk: 1:2500**



mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit minerar deri ne perfundim te aktivitetit, rehabilitimin e hapësirës se shfrytëzuar per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.

I percaktuar me fjale te thjeshta, VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimet dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara;
- Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis.

*Zhvillimi i Qendrueshem* eshte nje koncept kyç qe ka marre nje perhapje dhe pranim nderkombetar gjate dy dekadave te fundit. Agjenda 21, dhe plani global per zhvillimin e qendrueshem, theksojne rendesine e vendimarrjes se integruar te mjedisit dhe te zhvillimit, si dhe promovimin e VNM dhe instrumenteve dhe politikave te tjera per kete qellim.

#### Rendesia e VNM

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegël kyç per vendimarrjen ne nje zhvillim te propozuar. Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

#### Qellimet dhe objektivat e VNM

VNM-ja eshte nje proces qe ka si qellim kryesor identifikimin e pasojave ne mjedis, sociale dhe ekonomike te nje projekti para vendimarrjes per zbatimin e tij. Nepermjet VNM realizohet mbrojtja e mjedisit qysh ne fazen e hartimit ose dizenjimit te projektit, gjenden rruge ose menyra per te zvogeluar ndikimet negative, propozohen alternative ose zgjidhje te tjera per vendimmarresit. Qellimi dhe objektivat e VNM mund te ndahen ne dy kategori.

*Qellimi i pare*, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar si

te konsiderueshme e potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar.

*Qellimi perfundimtar*, afatgjate i VNM eshte te promovoj zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk minojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitetit si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

*Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:*

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit; dhe
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjene termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

*Objektivat afatgjate te VNM jane:*

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, pesiazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve; dhe
- Permireson aspektet sociale te projektit

VNM-ja eshte ne funksion te mbrojtjes se mjedisit dhe favorizon zhvillimin e qendrueshem, integrin mbrojtjen e mjedisit me marrjen e vendimeve qe ne fazat e hershme te planifikimit te aktiviteteve, mbron mjedisin dhe shmang pasojat sociale, ekonomike, kulturore dhe parashikon masat permiresuese per zbutjen e tyre ne rast te zhvillimit te nje aktiviteti, merr ne konsiderate perfshirjen e publikut, agjensive ose shoqatave ne vendimarrjen per zhvillimin e aktivitetit.

VNM-ja mund te coje ne reduktimin e koston dhe kohes per zbatimin e projektit dhe ne permiresime te ligjeve dhe rregulloreve. Procesi i VNM mund te arrije ne tre perfundime te mundeshme:

1. *Nuk ka efekte negative te projektit ose efektet jane te njohura por ndikimi nuk eshte sinjektiv*
2. *Efektet mjedisore nuk mund te njihen qe ne fazen e hartimit te projektit*
3. *Efektet e pritshme jane te konsiderueshme dhe sinjifikative ndaj duhet bere rishikimi i projektit.*

**Legjislacioni kryesor shqiptar per mjedisin, evolucioni i tij**

*Ministria e Mjedisit (MM)*

Per here te pare, ne vitin 2001 u krijua ne shqiperi Ministria e Mjedisit. Historiku i institucioneve ne mbrojtje te mjedisit fillon ne vitin 1991, kur brenda Ministrise se Shendetesise u krijua Komiteti per Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit. Ne vitin 1998, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin Nr.8364, 02.07.1998 “Per mjedisin”, ligj i cili transformoi Agjencine Kombetare te Mjedisit ne institucion te pavarur i cili ishte ne varesi direkte dhe raportonte tek Kryeministri. Krijimi i Ministrise se Mjedisit ne vitin 2001 vazhdoi perpjekjet dhe tendencen per t’i dhene rendesine e duhur autoriteteve te mbrojtjes se mjedisit. Ne vitin 2005, Ministria e Mjedisit, ndryshoi emertimin ne Ministria e Mjedisit, duke marre keshtu edhe me shume kompetenca ne pasuri te tjera natyrore te vendit si ujrat, pyjet dhe peshkimi. Pozicioni, dhe kompetencat e reja te autoriteteve te mjedisit brenda qeverise, krijojne mundesi per te ndermarre me shume veprime dhe nisma ambicioze per te forcuar kapacitetet administrative dhe per te ngritur institucionet e duhura pergjegjese per menaxhimin e mjedisit.

#### Autoritete te tjera ne nivel qendror qe lidhen me mjedisin

Komisioni Parlamentar per Shendetesine dhe Mjedisin, punon per Parlamentin dhe rishikon draft-ligjet e pregatitura nga MM, aprovon marreveshjet nderkombetare dhe organizon dhe aprovon debatet per ceshtjet e mjedisit. Ka dhe nje numer te caktuar Ministrish dhe institucionesh te tjera shteterore qe kane marre dhe marrin masa te rendesishme per mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit. Disa nga keto ministri kane krijuar departamente dhe njesi perkatese pergjegjese per mjedisin ne sektorin qe te mbulojne.

#### Ne nivel rajonal dhe lokal

Ne nivel rajonal, pergjegjese per mjedisin jane Agjencite Rajonale te Mjedisit (ARM), te cilat jane strukture e MM. Ne vendin tone jane 12 ARM te organizuara ne nivel Prefektore. Ne nivel lokal, njesite e qeverisjes vendore Bashkite, jane pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit, megjithse ne pergjithesi ato nuk kane staf te specializuar per problemet e mjedisit. Bejne perjashtim ketu Bashkite e nivelit te pare Bashkia Tirane, Durres, etj.

#### **Legjislacini i VNM-se**

Ligji pare per mjedisin eshte ai me Nr.7664, date 21 Janar 1993, i cili e permend VNM por nuk qarteson asnje procedure per kryerjen e saj.

Ligji dyte ne serine e legjislacionit mjedisor eshte ai me Nr.8364, date 02.07.1998 “Per mjedisin”, i cili serisht e ka kete difekt per VNM.

Duhet theksuar se vendi yne ka edhe legjislacionin e tij mjedisor te hartuar keto vitet e fundit, sidomos pas vitit 2002 kur edhe ka filluar plotësimi i kuadrit legjislativ ne fushen e mjedisit. Ky kuadër legjislativ permbledh te gjitha llojet e akteve legjislative duke filluar nga Kushtetuta e Republikes se Shqiperise, ligje te përgjithshme per mjedisin dhe per perberes te veçante te tij, vendime te këshillit te ministrave, urdhra dhe udhëzime te ministrive, rregullore specifike, norma e standarde, etj. Ky legjislacion eshte i përfaqesur me standartet e Bashkimit Europian sepse mbeshtetet ne te njëjtat parime qe eshte mbështetur legjislacioni

mjedisor evropian, por gjithashtu eshte hartuar me asistencen e eksperteve te huaj duke respektuar keshtu edhe konventat nderkombetare ku shteti shqiptar eshte pale.

Kuadri aktual ligjor per VNM eshte parashikuar ne:

- Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”

Direktivat kryesore ne te cilat janë mbështetur bazat kryesore ligjore janë:

- Direktiven 85/337/EEC te Keshillit te Europes
- Direktiven 2001/42/EC E te Parlamentit European dhe Keshillit te Europes
- Direktiven 2004/35/CE te Parlamentit European dhe Keshillit te Europes

Megjithate, legjislacioni mjedisor vazhdon te jete ne nje proces intensiv plotësimesh e permiresimesh per t’u pershatatur me standardet dhe normat me te mira mjedisore dhe per te siguruar nje zhvillimi te qendrueshem te ekonomise se vendit.

*Permbledhje te përgjithshme te karakteristikave te VNM-se*

<b>Qellim</b>	VNM
<b>Procesi i vleresimit</b>	Vlerësimi ---> Raporti ---> Miratimi ---> Monitorimi
<b>Shkalla e vleresimit</b>	E krahasueshme me ndikimet potenciale
<b>Mbulon fushat</b>	Mjedisore, Social-ekonomike, të trashëgimisë kulturore, etj
<b>Konsideron</b>	Politikën Mjedisore, Institucionale dhe Monitoruese
<b>Niveli</b>	I detajuar për një projekt
<b>Procedura e raportit</b>	Shtojca 1 – Projektet qe i nënshtrohen Procedures se Thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis Shtojca 2 – Projektet qe i nënshtrohen Procedures Paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis
<b>Baza ligjore</b>	Ne përmirësim te vazhduar
<b>Mbeshtetur</b>	Legjislacioni Shqiptar, Direktivat e EU (si Direktiva 87/11/EC) Praktikrat internacionale (si udhezuesit e Bankes Boterore OP 4.01).
<b>Adreson</b>	Çështje të projektit specifik

**Klasifikimi i aktivitetit sipas ligjeve baze**

Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) i veprimtarive ndertuese dhe prodhuese Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”

Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” përcakton detyrimet per Pajisjen me Leje Mjedisore te subjekteve fizike dhe juridike qe kerkojne te ushtrojne nje veprimtari qe ka ndikime ne mjedis.

Ligji Nr. 10 440 datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”Kreu II, Neni 7, shprehet:

- 1- Procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis i nenshtrohen te gjitha projektet dhe veprimtaritet qe jepen ne shtojcat 1 dhe 2 te ketij ligji, perpara miratimit te tyre nga organet perkatese.
- 2- Projektet dhe veprimtarite i nenshtrohen dy niveleve te shqyrtimit per vleresimin e ketij ndikimi:
  - Raport i thelluar i vleresimit te ndikimit ne mjedis
  - Raport paraprak i vleresimit te ndikimit ne mjedis

Si dhe mbeshtetur ne Vendimin Nr.805, dt 04.12.2003 “Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore“.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton nivelin e shqyrtimit per vleresimin e ndikimit ne mjedis te projekteve apo veprimtarive qe kerkojne operojne ne territorin e Republikes se Shqiperise para implementimit. Dy nivelet e shqyrtimit te VNM-ve jane:

Kerkesat e studimit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Mbeshtetur nga informacioni ne lidhje me karakteristikat e projektit, vendndodhjen e projektit (te dhena per mjedisin, banoret dhe kulturen) dhe impaktin potenciale te projektit, informacion i cili do te perdoret nga MM dhe do te percaktoje nevojen per nje VNM te Permbledhur apo te thelluar.



## KAPITULLI III

### PERSHKRIMI I VENDIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Zona ku do te ndertohet objekti ka nje peizazh te thjeshte pa ndonje vecori. Dhe toka ku do te ushtrohet aktiviteti eshte toke are.

#### 3.1 Pershkrimi gjeologo-morfologjik i zones

Rrethi i Tepelenës është një nga 36-të rrethet e Shqipërisë. Rrethi bën pjesë në Qarkun të Gjirokastrës. Rrethi i Tepelenës ka 55.000 banorë , një sipërfaqe prej 817 km<sup>2</sup> dhe kryeqendër Tepelenën. Tepelena ka karakteristika gjeomorfologjike kodrinore ku mbizotëron relievi kodrinoro-malor. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit është 732 m. Pika më e



lartë gjendet në majën e Këndrevicës 2122 m, ndërsa më e ulëta 105 metra në luginën e Vjosës. Litologjia e Tepelenës më së shumti përfaqësohet nga gëlqerorët, të cilat herë shfaqen pllakë e herë masive kompakte. Në këto të fundit, janë të zhvilluara pusët, shpellat dhe format e tjera karstike, mbi e nën tokësore me një interes të veçantë në fushën e turizmit dhe speleologjisë turistike e studimore. Relievi i zones ku do ndertohet objekti është heterogjen. Tokat janë vende-vende të kafenjta të mbuluara me gjelberim, zona me bimesi të zones.

### 3.2 Regjimi Klimaterik

Kushtet klimaterike të kësaj zone klasifikohen kryesisht në Klimën Mesdhetare Kodrinore - Malore nga kushtezimet e percaktuara nga të katër stinet. Përgjithësisht kushtet klimaterike të zones kodrinore-malore kanë klime tipike mesdhetare në ndryshim të temperaturës.

### 3.3 Regjimi i Reshjeve

Ndikimi i faktoreve ciklonike dhe anticiklonike, pozita gjeografike dhe relievi janë disa nga faktoret që luajnë rol të rëndësishëm në zonën që po trajtohet. Regjimi i reshjeve ka karakter stinor ku sasia më e madhe e reshjeve bie në stinën e ftohtë të dimrit dhe pjesërisht në vjeshtë dhe pranverë. 34% e sasive vjetore të reshjeve bie në muajt Dhjetor-Shkurt, 49.5% në periudhën Nëntor-Shkurt dhe 69% në Tetor-Mars. Në periudhën Tetor-Maj shpërndahen rreth 84% e sasive vjetore të reshjeve. Muaji më me shumë reshje është muaji Nëntor me rreth 150 mm ndërsa më pak reshje është korriku me 18-27 mm reshje. Në rajonin e Tepelenës sasia vjetore e reshjeve është 1350 mm/vit.

Mund të themi që tepelena ka një klimë mesdhetare të ndikuar nga lartësia e kodrave përreth duke krijuar një dimer pa reshje të dobëta dhe ngrica me temperatura që nuk zbrasin nën zero gradë celsius për një periudhë që shkon nga muaji Dhjetor deri në Shkurt mund të ketë vetëm pak ditë me temperatura që mund të zbrasin nën zero.

Vera është e freskët deri në të nxehtë me temperatura mesatare rreth 24 – 26 gradë dhe me pak reshje.

**Mjegulla** - nuk është e përhershme dhe është karakteristike e muajve Mars-Maj dhe Shtator-Nëntor.

**Vesa** – është një dukuri e përvitshme që mund të vëzhgohet në çdo muaj të vitit. Rastis me shumë në periudhën Prill-Tetor dhe Maj-Shtator.

**Bryma** - krijimi i së cilës kërkon që temperatura e sipërfaqes së tokës të jete nën 0<sup>0</sup> C zakonisht shfaqet në muajt Nëntor-Mars.

### 3.4 Regjimi i Temperatures

Po kështu temperatura ka luhajtje të mëdha. Temperaturat e ajrit justifikojnë kushtet e një klime tipike mesdhetare. Vëre të bute dhe të nxehtë dhe Dimer të bute. Për muajin më të ngrohtë (Korrik) temperaturat rrallë i kalojnë 15.3 gradë Celcius, temperaturat e muajit më të ftohtë (Janar) zbrasin deri në -1 shumë rrallë në -3 gradë Celcius.

### 3.5 Regjimi Atmosferik

Zona ku do zhvillohet aktiviteti karakterizohet nga nje atmosfere e paster e ajrit, pasi ne teritorin e kesaj zone nuk zhvillohen aktivitete qe ndikojne ne emetimin e substancave te ngurta, te lengta ose te gazta ndotes te atmosferes, nderkohe qe nuk emetohen shkarkime qe te ndikojne ne regjimin ushqimor, riprodhues migrues te habitateve te ndryshme.

### 3.6 Regjimi i Ererave

Nje nder elementet e rendesishem klimaterik eshte era. Ky element merr vlera te vecanta per shkak se krijon mundesine e shperndarjes se ndotjeve ne toke, ajer dhe uje nepermjet spostimit te masave ajrore. Ne shkaqet e formimit te ererave ne teritorin ne studim pervec faktoreve globale dhe rajonale ,veprojne dhe ato zonale dhe lokale. Ererat perendimore jane periodike te fresketa dhe me lageshtire. Ne rajonin e Tepelenes dhe ne teritorin ne fjale shpejtesia mesatare e ererave te ndjeshme nuk i kalon 15m/sek shpejtesi qe konsiderohet si relativisht e larte. Ne keto kushte klimaterike vegjetacioni zgjat rreth 7-8 muaj.

### 3.7 Habitatet dhe Biodiversiteti

Karakteristikat, topografia, toka, ujrat dhe prania e njeriut bejne qe teritori te popullohet me habitate te cilet nuk shquhen per vlera te vecanta dhe kane karakteristika tipike te habitatit te menaxhuar me intensitet pa ndonje impakt te dukshem per biodiversitetin. Zona klasifikohet ne habitatet tokesore te kultivuara dhe te menaxhuara. Vegjetacioni natyror eshte jo shume i pasur, kjo me shume per shkak te menaxhimit intensiv dhe pranise se njeriut se sa nga kushtet natyrore dhe klimaterike qe karakterizojne zonen. Ne zonen e pa menaxhuar, ne vitet e fundit ka shfaqje te flores se ulet. Prania e bimes barishtore spontane zevendesohen nga bime arash te kultivuara ne token bujqesore. Gjithashtu menaxhimi intensiv i habitatit ka kushtezuar nje faun te varfer, gjysem te ulet.

### 3.8 Flora

Flora e zones perbehet nga bimesi mesdhetare ne formen e saj me te thjeshte. Praktikisht ne kete zone ne vitet e fundit ka shfaqje te flores se ulet, bimesi barishtore spontane te stines, bime arash te kultivuara ne toke bujqesore ushqim per kafshet dhe dru dekorativ dhe frutore. Rrethi i Tepelenës është i pasur me bimësi, si në lloje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve, qe shtrihet deri ne lartësinë 600-800 metra, brezi i dushkut 800-1200 metra, pyjet fletëgjere, halore e të përzier dhe deri në kullotat alpine me lartësi mbi 1000 m. Zona per shkak te kushteve te vecanta te regjimit atmosferik, klimaterik gjeologjik eshte relativisht jo shume e pasur ne bimesi. Flora dhe fauna formojne nje sistem ekologjik teper kreativ dhe me vlera mjedisore. Bimesia ne shtrirjen vertikale eshte heterogjene duke filluar me bimesi te zones si shelg i rralle (Salix) dhe bimesi shkurore (Vitex Agrus Castus, Murizi), trendafil i eger (Rosa Canina) bimesi barishtore si gramiore te shumte grami (Cynodon Dactylon), xunkthi (Juncussp).

### 3.9 Fauna

Ne zonen ku do zhvillohet aktiviteti më të pranishëm janë zogjtë e llojeve të ndryshme, si mellenja, (Turdiac), kumria, harabelat (Gardelius e Gardelius spinus), dallëndyshet. Takohen insekte e zvarranikë të llojeve të ndryshme. Kafshet e egra në këto territor mungojnë ose janë shumë të rralla.


### 3.10 Sizmiciteti

Sizmika në rreth është tepër aktive. Fuqia sizmike e hasur në 1920 ka arritur në magnitudë 5,8 dhe intensitet 9 ballë. Tërmete të tjera ka pasur dhe në vitet 1963, 1969 dhe 1978. Rrethi i Tepelenës ndodhet në zonën e klimës mesdhetare kodrinore e malore. Temperatura mesatare vjetore është 15.3 gradë celsius, ndërsa mesatarja vjetore e reshjeve është 1426 mm. Ujërat sipërfaqësore përfaqësohen nga ato të lumit Vjosa dhe të degëve të tij (Drino-Bençe-Luftinje). Ujërat nëntokësore përfaqësohen nga burimet masive karstike si Uji i Ftohtë Tepelenë, Hormova, Lekel, Bença, Gurra në Progonat, Bulli në Dukaj.

### 3.11 Hidrogeologjia

Percaktohen nga baza e sotme e erozionit që është në nivelin e rrjedhjes së ujit të Limit të Vjoses. Ky lum është dhe furnizuesi më i mirë i tokës dhe i zhavorit për linjen e fraksionimit si dhe për kantierin e prodhimit të betonit dhe asfaltbetonit që në po studiojme. Erozioni për lumin e Vjosës, rezultatet tregojnë se humbjet e tokës për vitin 2013 janë rreth 250 m<sup>3</sup> tokë për të gjithë gjatësinë prej 300 ml të analizuar nga Ministria e Mjedisit. Lumi Vjosa rrjedh nga malet e Pindit në lindje të Janinës, kurse burimi gjendet në malin Mavrovouni. Rrjedha e tij vazhdon në drejtim të veriperëndimit për në Shqipëri. Lumi ka një gjatësi prej rreth 272 km, prej të cilave 80 km në territorin e Greqisë, kurse rreth 192 km brenda territorit të Shqipërisë. Pellgu i Vjosës përfshin një sipërfaqe prej 6,706 km<sup>2</sup>, 2,154 km<sup>2</sup> prej të cilave gjenden brenda kufijve të Greqisë, dhe 4,552 km<sup>2</sup> brenda kufijve të Shqipërisë. Prurja mesatare e ujrave në grykëderdhje është rreth 204 m<sup>3</sup>/sek. Pasqyra e nivelit të përhershëm të ujrave nëntokësorë luhaten sipas rreshjeve dhe prurjeve të lumit të Vjoses. Në këto rajonë takohen ujërat nëntokësorë në depozitat zhavorrë dhe në një thellesi 2.7 m deri në 5.5 m por në puset e shpimit ai arrin të ngrihet dhe të stabilizohet në 0.6 -0.8 m thellesi dhe në varesi të stinës niveli i tyre ndryshon. Në zonen ku do të ndërtohet objekti nuk ka burime sipërfaqësore. Në zonen e shfrytëzimit dhe përreth saj nuk ka zona të lundrueshme dhe nuk ndodhen liqene dhe dete.

### 3.12 Trashegimia arkitektonike, arkeologjike dhe historike



Nga konstatimi ne zonen ku do ushtrohet aktiviteti , ajo nuk ndodhet ne distanca te aferta me zonat e mbrojtura nga Instituti i Monumenteve te Kultures se Tepelenes dhe Gjirokastrës. Ne kete zone nuk ka objekte arkitektonike, arkeologjike, kulturore dhe me interesa historike te cilat mund te demtohen si pasoje e zhvillimit te aktivitetit.

## KAPITULLI IV

### PERSHKRIMI TEKNIK PROJEKTIT

Betoni dhe asfalto-betoni jane materiale qe nuk gjenden ne natyre ne menyre te drejtperdrejt por krijohet me perzierjen e komponenteve perberese : cimentoja , agregateti ( rere, zall) , uji dhe ne te shumten e rasteve edhe aditive, shtesave mineralogjike etj. Cimentoja si lende lidhese pas veprimit me ujin krijon nje strukture se bashku me agregatin qe me kohen ngurtesohet. Agregati paraqitet si mbushes qe ze pjesen me te madhe ne masen e betonit.

Uji zakonisht perdoret me  $ph=7$ .

Aditivet si komponente mund te themi se jane te domosdoshme sa i perket prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit dhe qe te permbushin kushtet e parashtuara me kerkesa te caktuara ( psh i papershkueshem ndaj ujit, qendrueshem ndaj ngrirjes/shkrirjes etj). Shtesat mineralogjike si komponente perdoren kur deshrojme qe te arrijme rezultate te larta ne nje drejtim, ndersa ne anen tjeter mos te shkaktohen rezultate te uleta ne drejtimet tjera ( psh te rritet soliditeti ne shtypje duke mos rritur shume sasine e cimentos). Betoni si material ka aftesi qe ne gjendje te njome te marre forma te cfaredoshme dhe ate forme ta mbaje pas

ngurtesimit me nej aftesi te konsideruar mbajtese. Prodhimi i betonit sipas kerkesave te caktuara kerkon percaktimin e sakte te sasise se materialeve perberes te tij.

Ne percaktimin e sasise se cimentos duhet te kihet kujdes qe te merren ne konsiderate keto elemente:

- Betoni qe do te perdoret
- Dimensionet e elementit apo konstruksionit
- Nxehtesia e hidracionit ne beton
- Aspekti i ekspozimit te konstruksionit

Meqenese agregati si komponente i betonit eshte me i lire ne krahasim me cimenton ateher edhe perdorimi i tij eshte ne sasi me te madhe ne prodhimin e betonit. Po ashtu ndikimi i agregatit eshte i konsiderueshem ne stabilitetin vellimor dhe jetegjatesine e betonit. Ne varesi te kerkeses per llojin e caktuar te betonit , me veti te caktuara behet edhe percaktimi i sasise se aditiveve. Betoni i njome eshte perzierje e ujit, cimentos, agregatit, aditiveve dhe eventualisht shtesave mineralogjike. Pas perzierjes se komponenteve perberese qellimi eshte prodhimi i nje mase uniforme , te pershtatshme per transport , hedhje ne veper, ngjeshje dhe rrafshim te siperfaqeve kur eshte ne gjendje te njome.

Vetite me te rendesishme te betonit te njome jane:

1- Perpunueshmeria (konsistenca) e betonit te njome.

Ne menyre praktike perpunueshmeria qendron ne lehtesine e hedhjes se betonit derisa te marr formen perfundimtare. Konsistenca e betonit paraqet shkallen e plasticitetit te betonit dhe nderlidhet me aftesine e betonit te njome qe hidhet ne veper dhe mundeson nje ngjeshmeri te mire.

2- Masa vellimore e betonit te njome.

3- Sasia e ajrit ( poreve) ne beton.

### **Sheshi per depozitim te lendes se pare**

Ne sheshin e prodhimit te betonit, asfaltobetonit dhe fraksionimit te inerteve do behet dhe depozitimi i lendes se pare te siguruar nga lumi Vjose si dhe cemento nga vendi dhe importi sipas rastit. Materialet e perdorura ne beton dhe asfaltobeton jane te vendit dhe merren nga lumi Vjose per te cilen kompania eshte e paisur me leje shfrytezimi. Kontrolli i cilesise se betonit behet ne laborator qe disponohet ne linjen e prodhimit keshtu cdo firme ndertimi per cdo sasi te caktuar betoni shoqerohet me certifikate cilesie. Kjo veprimtari kryhet me mjetet perkatese te ngarkim – shkarkimit. Subjekti ka dy linja per pergatitjen e betonit.

### **Linjat per pergatitjen e betonit**

Prodhimi i betonit realizohet nga perzierja e perbersave te betonit, konkretisht te inerteve te fraksionuara si rere, zall, cimento, uje dhe aditive qe nuk e ndotin mjedisin rrethues. Procesi i prodhimit te betonit eshte proces i cili nuk ka mbetje teknologjike. Gjithashtu procesi teknologjik qe zhvillohet eshte proces i cili nuk ka te beje me ndryshimin kimik te lendes, por vetem me ndryshimin fizik e mekanik te saj.

### **Keto linja kane te njejtin konfiguracion te skemes teknologjike :**

Linja perbehet nga bunkere metalike me vellim  $5 \text{ m}^3$ , per depozitimin e reres se zeze e te granilit sipas nevojës. Sillosit te depozitimit te cimentos (3 cope vertikal) me aftesi mbajttese rreth 60 ton, materialet nga bunkeret me transportierin horizontal dergohen me ushqyes e me tej kalojne sipas receptures se pergatitur ne nje peshore. Cimentoja dergohet nepermjet linjes se vecante nga silloset ne peshore. Materialet e peshuara dozohen me nje ushqyes me transportier per ne perzieresin e materialeve. Ne kete linje eshte instaluar edhe nje pluhurkapes. Per linjen e furnizimit me uje subjekti ka te instaluar nej bot metalik per kete qellim. Masa e perzier sipas nevojës kalon ne nje transportier qe dergon rast pas rasti betonin e thate per perpunimin per ne mjetin e transportit tip betoniere.

### **Lenda e pare per linje prodhim betoni dhe asfalto-betoni**

Kjo lende e pare me baze inerte lumi sigurohet nga operacionet e e tregut vendas si dhe cimento nga subjekte te licensuara te vendit.

#### **-Materialet qe perdoren per prodhimin e betonit**

1. Zhavorr lumi i franksionuar dhe i lare i dimensioneve  $0\div 4 \text{ mm}$ ,  $4\div 14 \text{ mm}$  dhe  $14\div 24 \text{ mm}$ .
2. Cimento sipas markes se kerkuar dhe e cila depozitohet ne sillose te mbyllura.
3. Uje
4. Konsumi i lendes se pare rreth  $50 \text{ m}^3/\text{ore}$

#### **-Materialet qe perdoren per prodhimin e asfalto-betonit**

1. Zhavorr lumi i franksionuar dhe i lare i dimensioneve  $0\div 4 \text{ mm}$ ,  $4\div 14 \text{ mm}$  dhe  $14\div 24 \text{ mm}$
2. Bitum i markes  $50\div 70$  i prodhuar ne rafinerine e naftes Fier. Bitumi depozitohet ne cistern te mbyllura te pajisura me system ngrohje me gaz.
3. Konsumi i lendes se pare eshte  $100 \text{ ton/ore}$ .

### **Lendet ndihmese**

- Lendet ndihmese per prodhimin e asfaltobetonit jane stobil, interol-al-98, sod kaustike, inter pil-oil lenda qe perdoret per diegje si solari, gazi per kaldaja dhe vaji qe perdoret per ngrohjen e bitumit pra vaj hidrotermir.
- Energjia elektrike Meret nga rrjeti elektrik i zones. Fuqia e instaluar eshte  $78 \text{ kw}$  relativisht e ulur dhe per pasoje puna e kesaj zdruktarie nuk provokon renie shqetesuese te tensionit elektrik. Vec kesaj ajo punon kryesisht para dite kur konsumi ne familje eshte akoma i ulet. Brenda ne sallën teknologjike, gjendet nje panel elektrik i pajisur me sistemin e leshimit dhe te mbrojtjes.

- Uji per prodhimin e betonit dhe per larjen e inerteve ne kantier meret nga nje pus i shpuar Brenda siperfaqes se kantierit.

#### 4.1 Lenda djegese

Procesi nuk perdor lende djegese, vetem perdorin mjetet e ngarkim- shkarkimit sipas normativave e kohes se punes.

Kapaciteti perpunues ne linjen e betonit eshte rreth 50 m<sup>3</sup>/ore.

Kurse ne linjen easfalto-betonit eshte 100 ton/ore.

Qendra e linjes është e kompletuar me një sistem për drejtim të automatizuar dhe mbikqyrjen e kantierit, me qender kontrolli të informatizuar, me ekran ku lexohet dhe orkestrohet gjithë nga mbikqyrësi i prodhimit, i cili heton e korrigjon të dhënat për përbërjen dhe peshën e dozave të shtesave të domosdoshme teknologjike. Kontrolli i plotë i gjithë ciklit të prodhimit përfshin dhe lagështinë e prodhimit . Çdo cikël dozimi është i ruajtur dhe vënë në dispozicion për prove laborator. Impianti plotëson të gjitha standartet teknike dhe mjedisore të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, duke paraprirë edhe plotësimin e atyre europiane.

**Marka e betonit qe prodhohet eshte :** Marka: Euro mix

Viti i prodhimit: 2008

Vendi i origjines: Greqi


Kapaciteti: 50 m<sup>3</sup>/ore

**Marka e asfalto-betonit qe prodhohet eshte: Marka: WIBAU**


Viti i Prodimit : 2005

Vendi i origjines: Gjermani

Kapaciteti: 100 ton/ore



**Skema teknologjike e prodhimit te betonit**



#### 4.2 Programi i punes

Per zhvillimin e projektit eshte kaluar ne disa faza

- Fillimisht eshte vendosur zona ne te cilet do ndertohej linja e prodhimit
- Ndarja e sheshit ne zona perkatesisht per zonen ku do te depozitohen lendet e para, parkimi i automjeteve etj.
- Faza e fundit ka te bej me sistemimin e linjes per zhvillimin e prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit.

#### 4.3 Plani i instalimit te linjes dhe afati zbatimit te tij

Fazat qe jane planifikuar per instalimin e linjes se prodhimit te betonit jane:

#### 4.4 Furnizimin me uje

Uji i pijshem per plotesimin e kerkesave te personelit qe do te punoje , do te merret nga burimi I ujit te ftohte, ndersa uji qe do te perdoret per pergatitjen e betonit dhe per larjen e inerteve do te merret nga pusi i shpuar Brenda ambjenteve te kantierit.

#### 4.5 Rrjeti i kanalizimeve te ujerave te zeza

Ne funksion te nevojave te objektit te sherbimit do te perdoret rrjeti ekzistues i kanalizimeve. Sistemi i evakuimit te ujerave te zeza per vete karakteristikat e kanalizimeve te zones do te jete nje sistem unitar. Perberja e ujrave te zeza nga destinacioni qe ka zona do te jene ujera komunale, te dala nga objekti. Normat e perdorimit te ujit per aktivitetin do te percaktohet nga destinacioni i perdorimit te ambjenteve te sherbimit, pas miratimit perfundimtar te projektit. Rakordimi altimetrik dhe planimetrik i rrjetit do te realizohet si zakonisht me



puseta te pergatitura ne vend ose te parafabrikuara. Gjithashtu ne rrjetin e kanalizimeve te ujrave te zeza do te vendosen puseta kontrolli ne distance 50m nga njera tjetra, ne largesi lineare te rrjetit. Evakuimi i ujrave atmosferike do te realizohet me ane te sistemit te kunetave dhe pusetave te vendosura ne anet e rugeve duke i derguar ato drejte kolektoreve rrugore. Kolektimi i te gjitha ujrave te zones do te realizohet ne kolektoret kryesore.

#### 4.6 Furnizimi me energji elektrike

Per furnizimin me energji elektrike do te behen instalime te reja dhe do te ndertohet kabine elektrike. Furnizimi me energji elektrike do te behet ne baze te kontrates qe do te lidhet me sistemin shperndares.

#### 4.7 Faza e funksionimit

Ne kete impiant jane te perfshira silloset e cimentos , silloset e ujit, diafragma prej betoni dhe vaskat e materialeve te granilit te fraksionuar, rere guri. Procesi i punes fillon me afrimin e materialeve prane vaskave me ane te eskavatorit me rrota. Autobetoniera afrohet prane transportierit levizes ku me aten e tecilit transportohet materiali sipas gramaturave te percaktuar per cdo marke betoni. Ne fund te transportierit levizes ndodhet nje hinke ku injektohet sasia e cimentos dhe e ujit njekohesisht. Hedhja e sasive te materialeve behet ne menyre automatike, impianti jep ne monitor marken e betonit te kerkuar si dhe sasine. Impianti ne menyre automatike ben nxjerrjen e materialeve te granilit dhe reres ne sasite e caktuar dhe njekohesisht behet dhe injektimi i cimentos dhe ujit.perzierja e materialit behet ne betonierat.

#### 4.8 Mbetjet dhe emetimet ne mjedis

Me poshte jepet nje pershkrim i detajuar i mbetjeve dhe shkarkimeve te tyre ne mjedis, sipas etapave te procesit, natyres, sasive te tyre dhe drejtimet ne te cilat ato shkarkohen se bashku me efektet e mundshme te demshme qe mund te krijohen per tani dhe per nje te ardhme te larget.

##### Mbetjet e ngurta

- Mbetje betoni dhe asfaltobetoni keto jane ne sasi te vogla dhe hyjne perseri ne proces

##### Mbetje te lengeta

- Ka shume pak : ne objekt behen vetem larje te thjeshta te dyshemese dhe territorit. Kjo sasi uji qe hidhet ne ambjentet e punes largohet nepermjet procesit te avullimit..Eshte ne sasira shume te vogla dhe perdoret jo shume dendur.

- Ujrat qe dalin prej ambjenteve higjeno-sanitare shkarkohen ne gropen septike te ndertuar nga pronari i aktivitetit, pasi impjanti i prodhimit te asfaltobetonit eshte instaluar ne nje zone ku nuk egziston sistem kanalizimi.

### Zhurmat

Pajisjet jane te disenjuara per mos kalimin e zhurmave te lejuara ne nje aktivitet industrial. Zhurmat vijne nga linja prodhuese te asfaltit. Ato ndihen kryesisht ne mjedisin e punes, ndersa persa i perket mjedisit rrethues nuk perbejne problem te dukshem.

### Vibracionet

Nuk paraqesin problem per popullsin qe ndodhet perreth, as per punonjesit qe punojne aty. Pajisjet jane te ekuilibruara ne menyre te kenaqeshme. Kjo fal konstruksionit dhe nivelit teknik te pergatitjes se tyre.

## KAPITULLI V

### VLERESIMI I NDIKIMEVE

#### *Metoda e zbatuar per parashikimin e ndikimeve ne mjedis*

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e me poshteme:

-Njohja me projektin dhe teknologjine e tij.

-Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.

-Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do te zhvillohet aktiviteti

-Njohja me infrastrukturen egzistuese dhe nevojten per infrastrukture te re per projektin.

-Njohja me lendet e para qe do te perdoren per zhvillimin e aktivitetit.

Duke njohur teknologjine e prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit u indetifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit ne linjen e prodhimit.

**Indetifikimi i ndikimeve** – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit dhe u indetifikuan ndikimet e mundeshme gjate fazes qe do te zhvillohet aktiviteti sipas receptoreve te mjedisit.

**Vleresimi i ndikimeve** – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme ben perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe parafron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

- *shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te identifikuara ( Shkalla)*

**Shtrirja fizike-** Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinor te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke nga linja e prodhimit te betonit eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te kete erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes ku do te instalohet linja.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem).

-**Kthyeshmeria** –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar ).

-**Rendesia** – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, linja e prodhimit te betonit ndodhet ne nje zone te miratuar. Zhurmat qe krijohen gjate proceseve te punes nuk perbejn ndotje akustike. Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne linje do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis.

## 5.1 Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve

Zhvillimi i aktivitetit “**Linje prodhim betoni dhe asfalto-betoni**” nuk ka ndikime ne shendetin e popullsisë se zones. Ky aktivitet nuk perdor lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullsisë perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata. Ne projekt nuk jane parashikuar ndryshime ne popullsinë e zones, te zhvendosjes se saj, per shkak te ketij projekti. Ne sheshin e zbatimit te projektit nuk ka patur qender te banuar.

Gjate fazes se funksionimit te linjes nuk ka ndikime negative ne shendetin fizike dhe mendor te popullsisë, por ka efekte pozitive ne punesimin direkt te popullsisë se zones duke rritur keshtu edhe nivelin e jeteses se tyre.

## 5.2 Nivelet dhe ndikimet e zhurmave

Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Cdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit. Shoqeria eshte kujdesur te importoje nga jashte pajisje bashkekohore dhe ne gjendje te mire teknike , ne menyre te tille qe zhurmat e krijuara prej tyre te mos sjellin ndotje akustike dhe te jene te demshme per mjedisin dhe shendetin e punonjesve. Ndikimet e zhurmave gjate fazes funksionale do te vijne nga mjetet qe do te sjellin lendet e pare ne linje, pajisjet e instaluar per perzierjen e agregateve per prodhimin e betonit dhe asfalto-betonit te gatshem sipas markave te caktuara. Niveli i zhurmave te ketyre

mjeteve transportuese eshte i atij niveli qe nuk influencon si per te punesuarit dhe per banoret dhe gjallesat per rreth tij. Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne objekt do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

### 5.3 Ndikimet ne rruge lokale dhe transport

Gjate instalimit te linjes se prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit do te kemi ndryshime ne mbulesen fizike e biologjike te tokes, por kjo nuk do te sjell rritje te mundesise se fenomenit te erozionit sepse shoqeria do te marr masat e duhura. Zhvillimi i aktivitetit nuk do te sjell shtim te trafikut te automjeteve te zones. Mjetet qe do te sjellin lendet e para do te levizin me shpejtesi te kontrolluar në mënyrë që të ulet rreziku i aksidenteve. Autobetonieret perfshihen ne makina teknologjike me permasa dhe pesha brenda kufijve te lejuara per qarkullim, levizin ne orare te caktuara dhe ne rruge dytesore.

### 5.4 Ndikimet ne flore dhe faune

Ky projekt nuk sjell shkaterrim te rendesishem te habitateve natyrore. Zona paraqitet me nje flore dhe faune jo shume te pasur. Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e percaktuar ne VKM nr. 804 date. 4.12.2003 “ Per miratimin e listes se specieve te flores Shqiptare , qe vihen ne mbrojtje” dhe e listuar ne urdherin e Ministrit nr. 146 date.8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”. Ndikimet negative mbi faune do te jene te ndryshme, mbi klasa te ndryshme te saj. Po ti referohemi pasurise se zones ne faune del se klasa qe ka ndikim te rendesishem eshte ajo e zvarranikeve, por specie qe do te preken jane te pa rendesishme dhe nuk figurojne nder ato te rrezikuara, mbrojtura endemike apo kercenuara. Nuk pritet ndryshim i ekosistemit pasi shoqeria eshte dhe do te tregohet mjaft e kujdeseshme ne zbatimin e teknologjive dhe metodave per prodhimin e betonit dhe asfalto-betonit si dhe do te jete e gateshme te zbatoje te gjitha masat qe do ti rekomandohen per uljen e ndikimit. Ndersa per te menjanuar erozionin nga ujerat e rreshjeve atmosferike ne perimentrin perreth objektit do te ndertohen kanale dhe kuneta qe ujerat te drejtohen ne zona qe nuk demtojne token si dhe habitatet e flores dhe faunes se zones.

### 5.5 Ndikimet ne toke

Gjate procesit te prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit sasia e inerteve perpara se te hidhet ne autobetoniere peshohet pra ajo eshte me mase te caktuar nuk ka shkarkime te teperta ne mjedis. Nje sasi fare e vogel te mbetjeve nga puna ne linjen e betonit dhe asfalto-betonit eshte rreth 0.5 % mase e cila riciklohet per riperdorimin ne linjen e pergatitjes se betonit. Persa i perket mbetjeve nga larjet e mjeteve te transportit te betonit sebashku me sasine e ujit qe realizon larjen e tyre kalojne ne vasken e ndertuar per dekantim te mases se ngurte ku qendrojne per nje kohe te caktuar dhe me pas shkarkohen ne mjedisin ujqor prites. Subjekti realizon larjen ne nje vend te caktuar brenda sheshit te objektit por referuar gjendjes

krahas arritjes kerkohet pastrim korrekt te kanalit te ujerave prej llumit te larjes se mjeteve dhe dherave te sheshit gjate reshjeve.

### 5.6 Ndikimet ne uje

Keto procese teknologjike nuk shoqerohen me shkarkime te lengeta te rrezikshme . Në këtë proces uji do të dozohet dhe perzihet me inertet dhe çimenton ne sasine e kerkuar per prodhimin e betonit dhe si rrjedhim nuk do te kete uje qe te dale nga procesi teknologjik. Ajo sasi e paket e ujit qe mund te derdhet kalon ne vaska dekantuese dhe me pas i bashkohet linjes se shkarkimit. Ujerat qe dalin gjate larjes se autobetoniereve dhe reshjeve orientohen permes kanaleve perkatese ne vasken e dekantimit dhe me pas per ne mjedisin ujqor prites. Projekti nuk ndikon negativisht në modelin drenazhues të zones. Ai do te zbatohet vetem ne nje siperfaqe shume te kufizuar dhe pa perdorim masiv te ujit. Zbatimi i projektit nuk çon në ndryshime hidrografike te nivelit të ujrave, të rrugëve ujore, të rrjedhjes të ujrave nëntoksorë dhe sipërfaqësorë etj. Ky projekt nuk ka ndikim në hidrologjinë bregdetare per shkak se ndodhet larg vijes bregdetare.

### 5.7 Ndikimet ne ajer

Referuar natyres se procesit nuk ka sasi gazesh te emetuara ne atmosfere por vetem perhapje te pluhurit. E cila eshte prezente ne shesh gjate kohes se thate nga levizja e mjeteve ne kohen e ngarkimit te materialit ne bunkeret e depozitimit e ndonje rast tek peshimi e furnizimi me cemento. Per shmangien e pluhurit behet sperkatje me uje her pas here ne sheshin e punes sidomos ne kohe te thate dhe me ere si dhe hermetizim sa me i mire ne linjen e furnizimit nga silloset ne perzieres. Gazet prej mjeteve jane ne interval kohore te shkurtera e pa ndonje ndikim ne mjedisin perreth.

### 5.8 Ndikimet ne klime

Gjate zhvillimit te projektit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

### 5.9 Ndikimet ne ekonomi

Persa i perket ndikimeve ekonomike ky projekt do te sjell efekte direkte ne punesimin e popullsise se zones gjate funksionimit te tij , pra do te rris tregun e punes si rrjedhim do te rritet edhe mireqenia e nivelit te jeteses te popullsise se zones. Duke qen nje aktivitet i prodhimit, tregtimit dhe shperndarjes se betonit dhe asfalto-betonit qe eshte nje element qe i vjen ne ndihme industries se ndertimit.

#### 4.10 Ndikime mbi trashëgimë kulture

Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulture, pra nuk kemi ndryshime apo demtime të saj duke qene se nuk ekziston në këtë territor. Aktiviteti që do të zhvillohet nuk prek zonat turistike, zona të mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte të trashëguara dhe të ndertuara nga njeriu me rëndësi historike, sepse në këtë zone ato nuk ekzistojnë. Është për t'u theksuar se në këtë zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonumente.

#### 4.11 Ndikimet me natyrë nderkufitare

Zhvillimi i aktivitetit « Linje Prodhim Betoni dhe asfalto-betoni » do të zhvillohet në fshatin Majkosh të Tepelenës, qarku Gjirokastrë pra ndodhet brenda territorit të vendit të tone dhe nuk ka ndikime me natyrë nderkufitare.

## KAPITULLI VI

### MASAT QË DUHEN MARR PËR ELEMENIMIN / MINIMIZIMIN E NDOTJEVE

Masat zbutese të ndikimeve negative konsistojnë në marrjen e masave për uljen e ndotjeve gjatë procesit të prodhimit të betonit, si të pluhurit në ajër, zhurmave, erozionet si dhe uljen e efekteve negative hapësirë në territor , faunë dhe florë.

#### 6.1 Masat ndaj erozionit

Kjo zonë nuk ka predispozim të theksuar për erozion në sipërfaqen e tokës, ky fenomen është në nivele të papërfillshme. Për shmangien dhe parandalimin e erozionit të zonës ku do ndertohet objekti dhe rrethinave përreth si dhe për ruajtjen e regjimit të rrymës së ujit të reshjeve dhe parametrave hidrodinamike të saj, në projekt është përcaktuar shfrytëzimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë të zonës në teresi.

Në zonën ku do zhvillohet projekti hap pas hapi dhe në përfundim të aktivitetit, është parashikuar sistemimi dhe mbulimi i një sipërfaqeje të konsiderueshme me dhëra humusore dhe bimesi të zonës.

Kjo sipërfaqe e përfutur nga trajtimet e mesiperme, do të japë mundësi për kultivimin e bimëve dhe pemëve të ndryshme, duke krijuar njëherësh kushte për parandalimin e erozionit dhe përmirësimin e pamjes së përgjithshme të zonës ku do ushtrohet aktiviteti.

#### 6.2 Masat për emetimet në ajër

Aktiviteti “Linje prodhim betoni dhe asfalto-betoni” nuk sjell emetime të gazeve në atmosferë sepse nuk përdoren lende djegëse gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij prodhues.

Lenda djegëse përdoret vetëm nga mjetet e transportit të lendeve të para si dhe produktit përfundimtar. Për mbrojtjen nga gazet e motorreve diezel do të merren këto masa :

1- Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.

2- Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

Procesi teknologjik ben peshimin e materialit inert per realizimin e markave te ndryshme te Betonit dhe asfalto-betonit. Ne te njejten kohe qe peshohet materiali inert ne peshoren tjeter peshohet çimentoja e cila vjen nga pika e furnizimit me bot. Sillosat jane te mbyllur ne menyre hermetike. Furnizimi behet me tuba gome . Ne linje eshte instaluar filtri i pluhurave te çimentos ne menyre qe pluhuri te mos dale ne atmosfere. Pra i gjithe procesi eshte nje cikel i mbyllur dhe nuk emeton pluhura.

Persa i perket pluhurave qe krijohen gjate procesit te ngarkimit apo shkarkimit te lendeve te para nga ana e shoqerise ne menyre periodike sidomos ne kohe te thate do te behet lagia e territorit me uje per shmangien e pluhurit. Transportuesit jane prej gome te hermetizuar si dhe ne linje do te instalohen filtra per pluhurat ne menyre qe te mos ket emetim te tyre ne atmosfere. Punonjesit do te jene te pajisur me maskat perkatese per mbrojtjen ndaj tij.

Perreth linjes do te behet sistemimi i ambientit per qellim mbrojtjen e peizazhit duke bere mbjelljen e pemeve me gjelberim te perhershem si dhe me lule dekorative. Nga ana e personelit te shoqerise do te tregohet nje kujdes i vecante per mirembajtjen e tyre.

### 6.3 Masat per uljen ne minimum te zhurmave

Burim zhurme është çdo makinë, instalim, mjet pune, mjet transporti, proces teknologjik, që lëshon zhurmë. Mbrojtja nga zhurma per zhvillimin e ketij aktiviteti duhet te sigurohet nga vet shoqeria aktiviteti te ciles e gjeneron ate. Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.

Masat qe do te merren per minimizimin e zhurmave nga ana e shoqerise jane:

- Makinat e transportit dhe pajisjet gjate fazes se ndertimit do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita selenciatore te pakesimit te zhurmave.
- Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat punetoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune “kufje”

### 6.4 Masat per Shkarkimet ne uje

Sic eshte theksuar edhe me siper ky proces nuk shkarkon ne mjedis uJOR prites ujera te ndotura nga procesi i prodhimit te betonit . Uji perdoret si element perzieres ne beton sipas recepturave te caktuara dhe nuk ka teprica te tij. Ujerat qe dalin gjate larjes se autobetoniereve dhe reshjeve orientohen permes kanaleve perkatese ne vasken e dekantimit dhe me pas per ne mjedisin uJOR prites.

Ne menyre periodike nga ana e shoqerise do te behet pastrimi i kanaleve orientues si dhe vaskes se dekantimit. Fraksionet e inerteve qe dekantojne aty rifuten ne procesin e prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit. Per levizjen e ujerave te shiut eshte ndertuar sistemi i

drenazhimit ndersa persa i perket ujerave te bardha dhe te zeza ato i bashkohen sistemit te kanalizimit te vendosur nga pushteti lokal.

### **6.5 Masat per Depozitimet ne toke**

Sheshi i ndertimit ka shume pak ose aspak vegetacion. Nuk do te jete nevoja per levizje volumesh te medha dherash, pasi terreni eshte relativisht i sheshte.

Mbetjet e ngurta qe vijne si rezultat i projektit jane dherat qe rezultojne nga germimet e bera per nivelim te territorit per instalimin e linjes se prodhimit. Keto dhera depozitohen ne nje vend te vecante ne menyre qe te riperdoren per rehabilitimin e zones.

Gjate procesit te funksionimit ky aktivitet nuk gjeneron mbetje te ngurta ne forme sterileshe te demshem per mjedisin, fraksionet e inerteve hidhen me masen e duhur ne autobetoniere per procesin e perzierje se betonit, ndersa masa e ngurte qe dekantton ne gropen dekantuese rifuten ne proces. Mbetje te tjera te cilat dalin nga aktiviteti i perditshem i punetoreve do grumbullohen ne kontenier dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga pushteti lokal i zones konform kerkesave te percaktuara.

### **6.6 Masat estetike dhe ekologjike**

Në projektin e shfrytezimit te linjes se prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit do te merren masat estetike dhe ekologjike te cilat konsistojne ne rregullimin e ambjentit te jashtem me lule dekorative per te krijuar nje ambjent te kenaqshem per syrin e njeriut. Lartesia e zyrave eshte projektuar relativisht e ulet, e harmonizuar me lartesine e objekteve per rreth dhe ne perputhje me studimin urbanistik te zhvillimit te zones.

### **6.7 Masat rehabilituese, në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit**

Masat për rigjenerimin e mjedisit do te konsistojne në:

- a. kryerjen e të gjitha punimeve të domosdoshme momentale rehabilituese, sipas projektit.
- b. krijimin e sipërfaqeve me mbjellje.
- c. sistemimin e materialeve dhe të sterileve që vijnë nga kryerja e proceseve te punes, të planifikuara në projektin inxhinierik.
- d. mbjelljen e sipërfaqeve të gjelberuara e mirëmbajtjen e sipërfaqeve të mbjella, etj.

### **Rastet aksidentale**

Zbatimi i ketij projekti nuk do te sjell rrezikshmeri per aksidente, duke qen se nuk do te kete mbajtje ose perdorim i substancave te rrezikshme. Jane marr masat per parandalimin e tyre, mjetet kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre ne menyre qe te mos kemi rrjedhje lubrifikante apo karburant. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

### **Rreziqet me pasoja ne mjedisin human dhe ekonomik**



- Aksidentet e punonjesve gjate procesit teknik ne objekt.
- Aksidentet si pasoje e renies se zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes per secilin nga rastet e me siperm do te varet shume nga masat mbrojtese qe do te parashikohen dhe zbatohen. Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me aksidente te cilat mund te sjellin pasoja te demshme ne mjedis si ndotje te ujerave nga lende te rrezikshme, emetime ne ajer nga gaze helmuese apo kontaminim te tokes.

### **Sigurimi teknik dhe mbrojtja ne pune**

Aktiviteti ‘Linje Prodhim betony dhe asfalto-betoni’ nuk perdor lende te demshme dhe te rrezikshme si per mjedisin ashtu edhe per punonjesit. Lendet e para qe futen ne proces nuk pesojne ndryshime kimike. Per shmangien e aksidenteve nga pajisjet dhe makinerit tregohet nje kujdes i vecante nga punonjesit per mirembajtjen e gjendjes se tyre teknike si dhe zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurimit teknik. Gjithashtu ne menyre periodike punonjesit instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre. Per te krijuar nje ambient pune optimal dhe funksional shoqeria COBIA sh.a do te pajise te gjitha punonjesit qe do te punojn ne linjen e prodhimit te betonit dhe asfalto-betonit me uniformat dhe mjetet mbrojtese perkatese.

Regulloret e Teknikes se Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik dhe shoqerise , do te zbatohen ne cdo proces pune te percaktuar ne plan- organizimin e kryerjes se proceseve te punes te hartuar nga drejtuesi teknik i punimeve dhe te miratuar nga drejtuesit e shoqerise , i cili do te permbaje :

- Plan organizimi i punes hartohet nga drejtuesi teknik.
- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, do te beje kontrollin teknik per ecurine dhe mbarevajtjen sa me te mire te proceseve te punes.
- Drejtuesi teknik i punimeve do te kryeje instruksione te rregullta mujore e tre mujore per punonjesit.
- Kujdes i vecante do te tregohet ne krijimin e kushteve te punes sa me konforte per punonjesit.

### **6.8 Masat ndaj zjarrit**

Rreziku ndaj zjarrit eshte prezent ne te gjitha mjediset, zjarri eshte nje djegie qe zhvillohet ne menyre te pakontrolluar ne kohe dhe hapesine , pra eshte nje reaksion kimik ndermjet nje trupi te djegshem dhe nje trupi qe djeg. Per te ulur shkallen e rrezikut ndaj zjarrit dhe sigurimin e mbrojtjen e personave nga ana e shoqerise do te merren masat ndaj mbrojtjes se zjarrit. Hidrantet do te vendosen ne zona te dukshme dhe punonjesit do te instruktohen per perdorimin e tyre ne raste aksidentesh. Punëdhënësi pas vlerësimit të rreziqeve të zjarrit dhe në bazë të planit të emergjencës, i përcakton punëtorët përgjegjës për zbatimin e masave të parandalimit të zjarrit, luftën kundër zjarrit dhe menaxhimit të emergjencave. Detyra e përgjegjësit është, jo vetëm të sigurojë që puna të kryhet në bazë të programit, por edhe që ajo të kryhet në kushte sigurie, duke respektuar masat e vëna në dispozicion nga eprorët, rregullat mbi kujdesin në punë, si dhe duke pretenduar që punëtorët të respektojnë standartet dhe të përdorin, nëse nevojitet, pajisje personale mbrojtëse si dhe të kontrollojnë

funksionimin e tyre. Ne raste zjarresh do te behet aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve te fikjes se zjarrit si dhe njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca).

Rruget hyrese ne linje do te projektohen ne menyre te tille qe te kete lehtesi per hyrjen e njesive te specializuara ne rastet emergjente.

## KAPITULLI VII

### PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT

*Monitorimi i mjedisit* eshte nje proces i cili duhet te permbaje nje program sa me te plote per te trajtuar dhe per te perballuar te gjitha problemet qe mund te lindin nga zbatimi i ketij projekti dhe per ti zvogeluar keto ndikime.

*Menaxhimi mjedisor* eshte nje siguri dhe nje mbeshtetje per zbatuesit e projektit per cdo avari te papritur qe mund te ndodh dhe gjithashtu mund te perdorin nje skeme te gatshem per te perballuar keto probleme qe mund te lindin gjate fazave te zhvillimit. Skema e menaxhimit mjedisor permban keto objektiva afat-gjata:

- Mbeshtetje e plote me legjislacionin dhe politikën e kompanisë
- Perzgjedhje te politikave me te mira mjedisore dhe te performancave te ndërtuara rreth parimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm te gjendjes se mjedisit
- Bashkepunim te plote te mjedisit me projektin
- Praktika me te mira per cdo nderhyrje mjedisore për të rritur ne kete menyre vlerat e efektivitetit
- Inkurajimi për të arritur performancën e lartë nga punonjësit dhe kontraktorët individualë
- Per te siguruar standardet për planifikimin e përgjithshëm, funksionimin, kontrollin dhe rishikimin
- Menaxhimi duhet të paraqese prioritetet mjedisore
- Të jetë i zbatueshëm në të gjitha fazat e projektit
- Para zbatimit te projektit duhet te zhvillohen konsultimet e para me banoret e zones dhe autoritetet vendore dhe te merren ne kosiderate cdo lloj ndihme vullnetare.

#### 7.1 Plani i menaxhimit te mbetjeve

Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe administrimit te tyre jane minimale per aktivitetin te cilin po trajtojme. Mbetjet urbane qe krijohen nga aktiviteti i perditshem i personelit hidhen ne vendin e caktuar per kete qellim dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga Bashkia

Tepelene. Grumbullimi dhe heqja e mbetjeve dhe sistemimi i mbetjeve sterile eshte pergjegjesi e shoqerise. Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga elementet e pershkruar me siper, subjekti nepermjet personelit te tij harton dhe zbaton nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis. Realizimi me sukses i ketij plani sjell nje sere perfitimesh per shoqerine te tilla si: ushtrimi i veprimtarise ne perputhje me ligjet dhe rregulloret, marrdhenie te mira me publikun dhe ambjentalistet, shmangia e penaliteteve nga organet e kontrollit te mjedisit etj.

Per te parandaluar efekte negative shoqeria :

- Do te perzgjedh teknologji plotesisht te kontrolluar dhe moderne me pajtueshmeri mjedisore.
- Zbatim rigoroz i rregullave te sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj duke zbatuar normat e vendosura per kete qellim kur konstatohet shkelje.
- Perdorimi i mjeteve mbrojtese ne pune
- Ne vendet te dukshme dhe me shkalle te larte rreziku te vendosen parrulla paralajmeruese.
- Tokezimi i te gjitha paisjeve qe punojne me energji elektrike per te shmangur aksidente me pasoja

Nga ana e shoqerise dhe stafit te saj do te kontrollohet:

- Paisja me mjetet e duhura te mbrojtjes nga zjarri (MNZ)
- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash.
- Sigurimi i ambalazhuesve te sigurt dhe rezistent per mbetjet (kazan, kova, kosha , qese etj).

Do te kete nderhyrje te menjehershme per riparimin e difekteve dhe avarive teknike, ne raste zjarresh do te behet aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve te fikjes se zjarrit si dhe njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca).

## 7.2 Plani i monitorimit te mjedisit

Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e projektit eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet ne se operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Bazuar ne kuadrin ligjor ekzistues te gjithe aktivitetet te cilet veprojne ne mjedis monitorohen persa i perket ndikimit qe ato kane ne mjedis. Ky monitorim behet ne menyre qe te nxjerrim konkluzione sa me te sakta per te kryer nderhyrjet e nevojshme.

Monitorimi do te perqendrohet kryesisht ne:

- Faktoret qe gjenerojne ndikime negative ne mjedis
- Efektet e ketyre ndikimeve
- Zbatimin e masave per zbutjen e tyre

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis.

Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga vete kompania ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit.

Me poshte jepen disa indikatore te cilet duhen monitoruar per te vleresuar suksesin dhe matur realizimin e objektivave mjedisore te projektit. Interpretimi i nje gjendje te caktuar mjedisore duhet bere ne lidhje te ngushte me fazen ne te cilen gjendet zbatimi i projektit.

Duhet kuptuar se nje gjendje e perkeqesuar e mjedisit ne nje faze te caktuar te zbatimit e cila eshte faze tranzitore nuk eshte tregues absolut i realizimit te objektivave te projektit.

Monitorimi per parametrin qe na intereson behet nepermjet matjeve te perseritura, qe merren me nje frekuence te mjaftueshme, per te bere te mundur vleresimin e gjendjes se mjedisit dhe ndryshimeve te tij ne kohe. Reduktimin e ndikimit mjedisor kompania synon ta arrijë duke:

- Zbatuar standarte ndërkombëtare;
- Zbatuar teknologji bashkohore
- Zevendesuar paisjet dhe mjetet e amortizuara
- Rehabilituar tokën brenda fushës së naftës
- Riparuar dhe ndërtuar rrugë të reja;
- Pastruar kanalet e kullimit

Me VKM per programin e monitorimit ne RSH jepen qarte indikoret mjedisor qe monitorohen, megjithate keta indikator duhet te pershaten dhe ti perkasin veprimtarise. Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e projektit te zbatuar eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet ne se operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me **ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.** Programi i Monitorimit, per parametrin qe na intereson behet nepermjet matjeve te perseritura, qe merren me nje frekuence te mjaftueshme, per te bere te mundur vleresimin e gjendjes se mjedisit dhe ndryshimeve te tij ne kohe. Reduktimin e ndikimit mjedisor kompania synon ta arrijë duke:

Zbatuar standarte ndërkombëtare;

- Zbatuar teknologji bashkohore
- Zevendesuar paisjet dhe mjetet e amortizuara
- Rehabilituar tokën brenda fushës së naftës
- Riparuar dhe ndërtuar rrugë të reja;
- Pastruar kanalet e kullimit

***Qellimet e monitorimit mjedisor:***

Per te vleresuar pasojat e ndotjes se mjedisit tek njerezit

- Studiuar bashkeveprimet midis substancave ndotese dhe objekteve mjedisore (vleresohet vecmas kontributi i secilit burim ndotes)
- Vleresuar nevojën e vendosjes se kontrollit ligjor per shkarkimet e substancave ndotese
- Per te vene ne veprim procedurat e emergjences ne zonat ku mund te ndodhin raste te renda te ndotjeve
- Per te krijuar nje arkive te cilesise se mjedisit, nje baze te dhenash qe perdoret ne te ardhmen
- Garantuar pershtatshmerine e nje objekti mjedisor per tu perdorur per qellim te caktuar

**Objektivat e monitorimit**

- Monitorimi i burimeve te shkarkimeve te gazta
- Monitorimi i burimeve te shkarkimeve te lengeta
- Monitorimi i burimeve te shkarkimeve te ngurta
- Monitorimi i nivelit te zhurmave ne ambjentet brenda territorit t e objektit dhe ne afersi te tij.

***Monitorimi i burimeve te shkarkimeve te gazta*** Per nje monitorim te vlefshem te burimit te ndotjes duhet te plotesohen dy kushte:

1. Mostra te pasqyroje me saktesi madhesine e shkarkimeve te substances ndotese ne stacionin e zgjedhur pergjate kohes.
2. Numri i mostrave te jete i mjaftueshem, qe rezultati i kombinuar i matjeve te tyre te perfaqesoje sa me sakte shkarkimet nga burimi.

***Monitorimi i burimeve te shkarkimeve te ngurta***

- Shkarkimet e ngurta me prejardhje te ndryshme, mbeturinat e ndotura etj. Jane me pak homogjene se ato te lengeta apo te gazta, per kete duhet kujdes per te garantuar qe mostrat e marra te jene perfaqesuese te verteta te burimit te shkarkimit.

- Kontrollonhet rregullisht depozitimi i mbeturinave bazuar ne permbajtjen e elementeve te rende.
- Objektivi i vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis është të evidentojë vlerat reale të treguesve mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysnisë në ajër, në ujëra të brendshme, në tokë, me qëllim që, në bazë të tyre, subjekti të ndërmarë masa dhe veprime korrigjuese të përshtatëshme dhe të zbatueshme për zonën ku ushtron aktivitetin. Për rastet kur ka ndotje që ndikojnë në situatën e shëndetit publik dhe në mjedis, të përcaktojë shkallën e ndotjes dhe nivelin e devijimit nga normat e lejuar, në mënyrë që programi rehabilitues të hartohet i sakte dhe masat e ndërhyrjes të jenë ato të duhurat dhe në nivelin e duhur.

### 8.3 Auditimi mjedisor

Zhvillimi i auditimit në terren do të marrë formën e inspektimeve periodike dhe mbikqyrjes të cilat duhet të përqëndrohen kryesisht në performancën mjedisore, përmes listave të hartuara. Pjesë e aktiviteteve të auditimit mjedisor përfshijnë vlerësimin e punes në terren dhe identifikimi i rreziqeve që mund të lindin gjate funksionimit të tij dhe masat zbutese që duhen të merren për zvogelimin e ndikimeve. Këto auditime bazohen në metoda dhe struktura të cilat japin informacione, keshilla dhe ndihme për zbatimin e tyre, në mënyrë që të përmbushen të gjitha objektivat dhe kërkesat mjedisore. Raportet e monitorimit duhen të hartohen në bashkëpunim nga specialistet e brendshëm të subjektit dhe nga specialist të jashtëm. Raporti i miratuar dhe rekomandimet duhet të zbatohet nga specialist i subjektit në mënyrë të përpikëte.

## KAPITULLI VIII

### KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

#### 8.1 Konkluzione

- Zbatimi i projektit nuk do të ketë pasoja negative të mundshme në mjedisin e zonës. Ndikime minimale do të ketë vetëm në ndryshimin e peizazhit të sipërfaqes ku do të instalohet linja e prodhimit të betonit dhe asfalto-betonit.
- Procesi teknologjik i prodhimit të betonit dhe asfalto-betonit nuk shoqërohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Ujërat që përdoren në linjën e prodhimit të betonit thuajse nuk kanë tepërca sepse dozohen në sasi të përcaktuara, sasitë minimale shkarkohen vetëm pas dekantimit të masës së ngurte në vasken dekantuese. Meqenëse lëndet e para të përdorura për prodhimin e betonit janë inerte, këto ujëra nuk kanë elemente që mund të kontaminonjë

mjedisin ujqor prites, sipërfaqësore, nentokësore apo tokën. Per asfalto-betonin qe lenda e pare pervec inerteve eshte dhe bitumi nuk ka shkarkime ne mjedisin ujqor prites sepse per te nuk perdoret uje.

- o Perreth perimetrit te objektit do te ndertohen kanalet drenazhues per ujerat atmosferike ne menyre qe te shmanget fenomeni i erozionit.
- o Ky aktivitet nuk perdore lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullsise perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.
- o Ky projekt nuk sjell emetime te gazeve ne atmosfere . Gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit te materialit ne bunkere, behet pluhur i lehte dhe drejtuesit e shoqerise do te marrin masa per sperkatjen me uje te bunkereve, për paisjen e punëtoreve dhe manovratorve te mjeteve te renda me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, kapele mbrojtese, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.
- o Niveli i zhurmave qe vijne nga automjetet dhe pajisjet e tjera jane brenda normave te lejuara. Nuk perbejne problem shqetesues per punonjesit dhe as per banoret e zones perreth qe jane ne nje distance te konsiderueshme.
- o Furnizimi me uje do te sigurohet nga pusi i shpuar Brenda kantierit
- o Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike.
- o Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore , pra nuk kemi ndryshime apo demtime te saj duke gene se nuk ekziton ne kete territor.
- o Per nje pune sa me optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punetoret e manovratoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesit teknik te firmes.

## 8.2 Rekomandime

Duke ditur se gjate proceseve te punes ne linje emetohen në mjedis pluhur i lehte, ka zhurma te makinerive për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis, duhet të:

- o Te behet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike te automjeteve.
- o Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis.
- o Te behet monitorimi periodik i emetimit te pluhurit ne ajer.
- o Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik.
- o Te pastrohen dhe mirembahen kanalet e drenazhimit te ujerave perreth perimetrit te linjes.
- o Te kontrollohet kompletimi me mjete mbrojtese nga zjarri.
- o Te respektohen normat e teknikes se sigurimit ne pune nga punetoret.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 103 Prot.

Tiranë, më 10.12 2014

Nr. identifikues 241

## CERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ELGERTI BIXHA

Certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

  
Lefter KOKA







REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,  
Tregëtisë dhe Sipërtarrjes

LICENCË

LN 8931-12-2014

NUIS/NIPT: L42006015E

Subjekti: GLOBAL ENVIRONMENTAL CONSULTING

Adresa: TIRANE, TIRANE, TIRANE, Njesia bashkëqeverisëse nr 5, rruga "Yase Pasha", pallati 1, shk 1, ap 5, përfaqëse Magje d. ish blloku

Kodi: III.Z.A.(1-2)

Kod ijetor:

Data e lëshimit: 29/12/2014

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shtetërore ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin mjedis

Nenkatëgoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin mjedis

*Handwritten in blue ink: GRIK V*

Veprimtari specifike

- 1. Ndikim mjedis
- 2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emertimi pershkimes i veprimtarisë  
Veprimtaria e ekspertizës lidhur me ndikimin mjedis (Auditim mjedisor)



Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjitha territorin e Republikës së Shqipërisë

Nenshkrimi i sportelit:

*Handwritten signature: Anabela...*





**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

**GJENDJA E REGJISTRIMIT**


1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NPT)	L42006015E
2. Data e Regjistrimit	06/08/2014
3. Emri i Subjektit	GLOBAL ENVIRONMENTAL CONSULTING
4. Forma ligjore	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
5. Data e themelimit	29/07/2014
6. Kohëzgjatja	Nga: 29/07/2014 Deri: 5/3
7. Sella	Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkëpunimi 5, rruga Vaso Pasha, pallati 1, shk 1, ap 5, perballë Magic 4, ish blloku
8. Kapitali	100.000,00
9. Numri i pjesëve 9.1 vlera nominale	100,00 1.000,00
10. Të dhëna mbi shlyerjen e kapitalit	
11. Objekti	Te japë Konsulencë në fushën e mjedisit dhe disiplinat e tjera inxhinierike, si projektim apo zbatim projektesh, minerare, bujqesore, ndërtim infrastrukture etj.; Te kryejë Vlerësimin Strategjik Mjedisor për politika dhe plane zhvillimi; Te kryejë Vlerësimin e ndikimit në mjedis për projekte të ndryshme dhe të hartojë raportet përkatëse; Vlerësimi i riskut mjedisor; Te hartojë projekte mjedisore dhe rehabilitimin e zonave të ndotura; Te realizojë auditime mjedisore dhe supervizionin e parametrevë mjedisore të ndryshme me ndikim në mjedis; Te hartojë per mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;



<p>OKR  <small>OFFICE OF THE          COORDINATOR          FOR THE          ENVIRONMENTAL          IMPACT ASSESSMENT</small></p>	<p>OKR  <small>Office of the          Coordinator for the          Environmental Impact          Assessment</small></p>	<p>te menaxhimit te zonave te mbrojtura. Te hartoje plane te menaxhimit te faunes; Te kryeje studimin e fizibilitetit per aktivite minerare, shfrytezim te kapaciteteve hidroenergjitike te lumenjve dhe perrenjve etj.; Te ofroje konsulence ne fushen e GIS dhe perpunimin e hartave GIS etj. Te ofroje asistencë ne pergatitjen dhe zhvillimin e konsultimeve me publikun per aspektet mjedisore te veprimtarive te ndryshme; Te hartoje projekte qe lidhen me ndergjegjesimin dhe pjesemarrjen e publikut ne ceshtjet mjedisore; Te hartoje dhe zbatoje projekte per trajtimin e ujerave te ndotur dhe azyre industriale, ujerave bragdetare ne toresi dhe brigjeve, te trajtimin te jashteqytjeve te kafsheve dhe ujerave te ndotur blegtorale; Te ofroje ekspertize ne fushen e menaxhimit te pyjeve dhe kullotave; Te ofroje konsulence ne projektet per forcimin e kapaciteteteve administrative te mjedisit nga pushteti vendor dhe ai qendror; Te ofroje asistencë teknike per projektet qe kane si objekt zbatimine standarteve per mjedisin te organizmave te ndryshem financiare nderkombetare; Te realizoje trajnime ne fushen e mjedisit, pyjeve dhe biodiversitetit; Te prodhoje te dhena dhe informacion, te realizoje botime dhe te tregtojte informacionin e prodhur vete. Monitorimi i ndikimeve dhe shkrkimeve ne mjedis dhe hartimi i raporteve perkates; Zbatim i projekteve te rehatimit te perrenjve dhe lumenjve dhe pyllzime; Zbatim projektesh per mbrojtjen e tokes; Prodhim fidanesh dhe mbledhje e farave. Koordinim, menaxhim dhe vleresim i projekteve; Studim dhe vleresim (anketime) social dhe ekonomik; Trajnimi i biznesit per menaxhimin mjedisor dhe supervizimi i sARBIMEVE mjedisore; Pergatitje plan-biznesi dhe investime; Nder te tjera mund te marre interesa, kuota, aksione dhe pjesemarrje te shoqerive te tjera dhe ndemarrjeve qe kane qellime te njejta apo qe kane lidhje ose gjithesei mund te ndihmojne ne arrijten e qellimit te objektit te shoqerise.</p>
<p>12. Përfaqësuesit ligjor</p>	<p>Afati i emërimit</p>	<p>Elgerti Bixha</p>
		<p>Nga: 29/07/2014          Deri: 24/09/2019</p>
<p>13. Kufizime të kompetencave</p>		
<p>14. Ortakët</p>	<p>Pjesët e zotëruara          Përqindja e pjesëmarrjes</p>	<p>Elgerti Bixha          100,00          100,00</p>
<p>15. Venë të tjera të ashtirimit të akt vitetit</p>		

COBI

59




OKR

6. Të dhëna njoftuar vullnetarisht	Emri Tregtar: GLOBAL ENVIRONMENTAL CONSULTING E-Mail: elgert_bixha@yahoo.com Telefon: 0698655999
17. Statusi	Aktiv

datë: 30-09-2014

COBIAL



Emri, Mbrojtja  
(i nëpunësit të sportelit)

Sh. 9

